

STATUTI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUARA
“Leo Alumil ” shpk

Në këtë statut

- “Ligji” është Ligji Nr. 9901, dt. 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare”;
- “Statuti” është Statuti i shoqërisë;

KREU I

Themelimi, Emri, Objekti, Kohëzgjatja dhe Selia e shoqërisë

Neni 1

Data e themelimit, Emri dhe Themeluesi

Shoqëria “**Leo Alumil ” shpk** themelohet në Berat me datë 09/10/2023 nga themeluesi:

Leonard Topanji, i biri i Barjam Topanji, e datëlindjes 24.11.1983, lindur në Berat dhe banues në Berat në adresën Lagjia “Clirim “ Pall 77/2, Hyrja 1, Apartamenti 17, person me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit me Nr. 027494682 dhe Nr. Personal I31124001G

dhe

Arber Durro i biri i Shkelqim Durro i datëlindjes 25.09.1978 , lindur ne Berat dhe banues ne Berat. mbajtes i leternjoftimit nr 037723819 dhe Nr. Personal H80925064L

Neni 2

Organizimi

Shoqëria “**Leo Alumil ” shpk** do të organizohet në formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar.

Neni 3

Kohëzgjatja

Shoqëria “**Leo Alumil ” shpk** është krijuar për të ushtruar veprimtarinë e saj për një afat të pacaktuar kohe.

Veprimtaria e shoqërisë fillon nga data e regjistrimit të saj në regjistrin tregtar dhe kjo veprimtari do të vazhdojë të ushtrohet në përputhje me legjislacionin në fuqi, dhe çdo ndryshim qe do të bëjë shoqëria do të reflektohet në aktet e shoqërisë.

Neni 4



Selia

Selia e shoqërisë ndodhet ne Bashkia Berat, Njësia Administrative Otlak, Fshati Dyshnik, zk 1587, nr pasurie 1405/112/1 fshati Dushnik

Shoqëria mund të zhvillojë aktivitetin e saj brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë nëpërmjet hapjes së degëve dhe zyrave të përfaqësimit. Hapja e degëve dhe zyrave të përfaqësimit bëhet sipas parashikimeve të nenit 9 të Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

Neni 5

Objekti i veprimtarisë



Shoqëria "Leo Alumil" shpk do të ketë si objekt të veprimtarisë së saj:

Prodhimi i dyerve dhe dritareve metalike

Shoqëria mund të kryejë dhe cdo veprimtari tjetër e cila është në ndihmë dhe e lidhur me objektin kryesor të veprimtarisë së saj.

KREU II KAPITALI

Neni 6

Kapitali themeltar

Kapitali i regjistruar i shoqërisë është 10000 (Dhjetemije leke) lekë. i perbere nga 2 kuota Pjesëmarja e ortakve themelues në kapitalin e shoqërisë është si më poshtë:

Ortaku Leonard Topanji, zotërues i 1 (nje) kuote me vlerë 5500(pesemije e peseqind) lekë, e cili zotëron 55% të kapitalit themeltar të shoqërisë;

Ortaku Arber Durro, zoterues i 1(nje) kuote me vlere 4500(Katermije e peseqind) leke i cili zoteron 45% te kapitalit te shoqerise

Neni 7

Llojet e Kuotave, të Drejtave dhe Kufizimeve

Në përputhje me dispozitat e Ligjit dhe pa cënuar të drejtat që rrjedhin nga kuotat ekzistuese, kuotat mund të emetohen me të drejtat ose kufizimet e parashikuara në vendimin e Asamblesë së Përgjithshme, e cila merr vendime ne perputhje me nenin 81, pika 3 e Ligjit Nr. 9901, date 14.04.2008.

Neni 8

Çertifikatat e kuotave

Ortaku ka të drejtë të përfitojë një çertifikatë për kuotat e zotëruara prej tyre, të cilat lëshohen nga ana e shoqërisë. Çertifikata nuk do të gëzojë cilësinë e letrës me vlerë.

Neni 9

Mënyrat e fitimit dhe kalimit të kuotave

Kuotat e kapitalit të shoqërisë dhe të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

Neni 10

Zmadhimi dhe Zvogëlimi i Kapitalit Themeltar

Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve me vendim, mund të zmadhojë kapitalin themeltar të shoqërisë duke rritur kuoten e ortakut ekzistues në shumën e përcaktuar në

vendimin përkatës. Zmadhimi i kapitalit me qëllim pranimit të ortakëve të rinj në shoqëri, miratohet nga ana e asamblesë së përgjithshme të ortakëve të shoqërisë sipas nenit 81 pika 3 të Ligjit 9901.

Shoqëria mund të vendosë zvogëlimin e kapitalit themeltar të shoqërisë me vendimin e asamblese së përgjithshme të ortakëve të shoqërisë sipas nenit 81 pika 3 të Ligjit 9901.

Neni 11

Blerja e Kuotave të Veta

Shoqëria mund të blejë kuotat e veta dhe të kryejë pagesa për blerjen e tyre, jo nga fitimet e shoqërisë që do t'u shpërndahen ortakëve apo emetimi i kuotave të reja vetëm nëse shoqëria përmbush kushtet për shpërndarjen e fitimeve sipas nenit 77 të Ligjit dhe Administratori lëshon një certifikatë të aftësisë paguese të parashikuar nga ky nen. Në rast se blerja e kuotave të veta nuk është në përputhje me kushtet e nenit 77 të Ligjit, paditë mbi përgjegjësinë e shoqërisë mund të ngrihen në pajtim me parashikimet e nenit 78 dhe 79 të Ligjit "Per tregtaret dhe shoqërite tregtare".

Neni 12

Kalimi i Fitimeve në Kapitalin Themeltar

Asambleja e përgjithshme e ortakëve mund të vendosë të kalojë në kapitalin themeltar të shoqërisë fitimet e pashpërndara të cilat nuk do të përdoren për të paguar dividendë preferencialë apo shuma të tjera të parashikuara për rezervat e kapitalit të shoqërisë.

Neni 13

Shpërndarja e fitimit

Ortaku ka të drejtë të marrë pjesën e fitimit të deklaruar në pasqyrat financiare të shoqërisë.

Shoqëria mund t'u shpërndajë fitime ortakut, vetëm nëse pas pagimit të dividendit:

- a) aktivet e shoqërisë mbulojnë tërësisht detyrimet e saj;
- b) shoqëria ka aktive likuide të mjaftueshme për të shlyer detyrimet që bëhen të kërkueshme brenda 12 muajve në vazhdim.

Administratori lëshon një certifikatë të aftësisë paguese, e cila konfirmon shprehimisht se shpërndarja e propozuar e dividendëve përmbush kërkesat e nenit 8/1, ndërsa kur gjendja e shoqërisë tregon se shpërndarja e propozuar e dividendëve nuk i përmbush këto kritere, administratori nuk mund ta lëshojë këtë certifikatë.

Neni 14

Ushtrimi i veprimtarisë

Veprimtaria ekonomike e shoqërisë realizohet në bazë të dobisë ekonomike dhe pasqyrohet në bilancet e saj. Bilanci i aktivitetit të shoqërisë duhet të përfundojë dhe të jetë i miratuar brenda mars të vitit pasardhës. Bilancet e shoqërisë mund të bëhen nga vetë shoqëria ose nga ekspertë të caktuar prej saj.

Shoqëria krijon fondet e saj, përveç krijimit të fondeve të detyruara sipas ligjit, të cilat do të përdoren për zhvillimin e zgjerimin e veprimtarisë së saj sipas rregullave në fuqi. Përbërja e këtyre fondeve caktohet me vendim të asamblese së përgjithshme të ortakut të shoqërisë sipas nenit 81, pika 3 të Ligjit 9901.

Shoqëria është pronare e mjeteve të saj financiare dhe i disponon vetë ato.

KREU III
ORGANET VENDIMARRËSE DHE DREJTUESE TË SHOQËRISË

Neni 15
Organet drejtuese të shoqërisë

Organet drejtuese të shoqërisë janë:
Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve
Administratori

Neni 16
Asambleja e Përgjithshme

Asambleja e përgjithshme është organi i vetëm vendimarrës i shoqërisë.

Asambleja e përgjithshme është organi i vetëm vendimarrës i shoqërisë që ka për kompetencë ndryshimin e statutit të shoqërisë sipas përcaktimeve ligjore.



1. Asambleja e përgjithshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Te drejtat dhe detyrimet e asamblese së përgjithshme ushtrohen nga ortaku i vetëm konform neni 81, pika 3 të Ligjit 9901.

Neni 17
Marrja e vendimeve

Te gjitha te drejtat dhe detyrimet e asamblese së përgjithshme ushtrohen nga ortaku i vetëm. Te gjitha vendimet regjistrohen në një regjister të vendimeve. Duhet regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për



- Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtaris e
- Shperndarjen e fitimeve dhe mbulimin e humbjeve
- Investime
- Vendimet per riorganizimin dhe prishjen e shoqerise

Neni 18

Emërimi i Administratorit

Administrator i shoqërisë i emëruar nga mbledhja themeluese është:

Leonard Topanji, i biri i Barjam Topanji, e datëlindjes 24.11.1983, lindur në Berat dhe banues në Berat në adresën Lagjia "Clirim" Pall 77/2, Hyrja 1, Apartamenti 17, person me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit me Nr. 027494682 dhe Nr. Personal I31124001G

Afati i emërimit të administratorit është 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorit fillon të prodhojë efekte pas regjistrimit të tij në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit. Mandati i administratorit fillon me datë 09.10.2023 dhe mbaron me datë 09.10.2028.

Neni 19

Kompetencat e Administratorit

Administratori ka të drejtë si dhe detyrohet të:

- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatisë dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqet këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- d) krijon një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- e) raportojë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

ë) kryejë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Neni 20

Perfaqësimi

Kufizimet e tagrave të përfaqësimit të administratorit i kundrejtohen palëve të treta, në përputhje me dispozitat e nenit 12 të Ligjit 9901.

Tagrat e përfaqësimit të administratorit dhe çdo ndryshim i tyre njoftohen për regjistrim pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

Neni 21

Shpërblimi dhe Përfitimet e tjera te Administratorit

Administratori shpërblehet në bazë të Vendimit të marre nga Asambleja e Përgjithshme në përputhje me parashikimet e Nenit 97 të Ligjit "Per tregtarët dhe shoqërite tregtare".

Neni 22

Kufizimet e Administratorit

Administratori i shoqërisë, në ushtrimin e veprimtarisë së tij mban parasysh kufizimet që rrjedhin nga neni 13 i Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" Ai në asnjë rast nuk lejohet të lidhë kontrata huaje dhe garancie me shoqërinë.

Kontratat e tjera të lidhura midis këtij personi dhe shoqërisë regjistrohen në një procesverbal, i cili bëhet në zyrën qendrore të shoqërisë.

Në rastet kur ai vepron në kundërshtim me parashikimet e nenit 13 dhe nenit 14/5 të statutit është vetë subjekt i dënimeve të parashikuara në nenin 13, pika 7 e ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", si dhe përgjigjet vetë në mënyrë solidare e shoqërinë me të gjithë pasurinë tij sipas parashikimeve të nenit 16 të Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

Neni 23

Përgjegjësia e Administratorit

Administratori është përgjegjës individualisht ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

Neni 24

Marrëdhëniet e punësimit në shoqëri

Marrëdhëniet e punës me punonjësit që do të punësohen pranë shoqërisë rregullohen me kontratën e punës individuale që do të lidhet me secilin prej tyre.

KREU IV

VITI FINANCIAR- EKSPERTËT

Neni 25

Viti financiar i shoqërisë fillon me datë 1 Janar të cdo viti dhe mbaron me datë 31 Dhjetor të cdo viti.

Neni 26

Ekspertët

Eksperti ka për detyrë të kontrollojë të gjithë dokumentacionin të veprimtarisë ekonomike tregtare të shoqërisë, atë gjithë vjetor dhe atë të në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar me një gjë të tillë nga ana e asamblese se përgjithshme te ortakeve te shoqërisë.

Në përfundim të kontrollit eksperti kontabël i certifikuar paraqet me shkrim raportin për nxjerrjen e rezultatit financiar të bilancit vjetor, si dhe për atë të kontrolleve periodike të

kryera prej tij, të cilat është i detyruar t'i dprëzjë në kohë për tu shqyrtuar nga ana e asamblese se pergjithshme te ortakeve të shoqërisë.

KREU V PRISHJA LIKUIDIMI

Neni 27

Prishja dhe likuidimi

Shoqëria "Leo Alumil" shpk priset:

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të asamblese se pergjithshme
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";
- d) me vendim të gjykatës.

Prishja e shoqërisë tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi. Rregullat për procedurën e zakonshme të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese jane Nenet 191 deri në 203 të Ligjit 9901.

Shoqëria likuidohet me procedurë të thjeshtëzuar, në përputhje me nenet 204 dhe 205 të Ligjit 9901.

Neni 28

Shndërimi i shoqërisë

Asambleja e pergjithshme, ka të drejtë që me vendim të vendosë për shndërrimin, transformimin e shoqërisë në ndonjë formë tjetër të shoqërive tregtare, duke zbatuar rregullat në fuqi.

Neni 29

Riorganizimi shoqërisë

Shoqëria mund të ndahet të bashkohet me vendim të asamblese se pergjithshme te ortakeve. Ky proces do të bëhet në përputhje me rregullat e parashikuara në Pjesën IX të Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

Neni 30

Baza ligjore

Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë e saj në përputhje me këtë statut dhe legjislacionin në fuqi.

Për atë që nuk parashikohet në këtë Statut do të zbatohen parashikimet e ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe të çdo ligji tjetër në fuqi në Republikën e Shqipërisë

ORTAKET

**Leonard Topanji
Arber Durro**

